



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
STANDARDET E RAPORTIMIT DHE TË MBIKËQYRJES SË BYROSË
SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 104, datë 30.06.2021

Neni 1

Objekti

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rolit mbikëqyrës, përmbajtjes, afateve, kërkesave për raportim dhe miratim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit (referuar më poshtë si Byroja), në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (referuar më poshtë si Autoriteti).

Neni 2

Baza ligjore

Kjo Rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 35, pika 9, të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.

Neni 3

Qëllimi i mbikëqyrjes

Nëpërmjet ushtrimit të kompetencave mbikëqyrëse ndaj Byrosë synohet monitorimi dhe zbatimi i:

- a. Detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil;
- b. Detyrimeve ligjore që lidhen me trajtimin e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit;
- c. Pagesave të dëmeve nga Fondi i Kompensimit;

d. Detyrimeve të tjera ligjore që lidhet me veprimtarinë e Byrosë.

Neni 4

Mënyrat e monitorimit/mbikëqyrjes

1. Mbikëqyrja e Byrosë kryhet nëpërmjet raportimit periodik në Autoritet sipas përcaktimeve, formës dhe përmbajtjes së përmendur në këtë rregullore si dhe formularëve të standardizuar bashkëngjitur.
2. Mbikëqyrja e Byrosë përmes inspektimeve në vend do të bëhet nëse Autoriteti e gjykon të domosdoshme dhe sipas rregulloreve të miratuara nga Autoriteti për mbikëqyrjen e subjekteve financiare jobankare.
3. Nëse e konsideron të nevojshme, Autoriteti ka të drejtën e parashtrimit të kërkesave të tjera për raportim nga Byroja.
4. Mbikëqyrja e dëmeve objekt Fond Kompensimi dhe Karton Jeshil kryhet edhe nëpërmjet regjistrimit elektronik të dëmeve.

Neni 5

Komunikimi me Autoritetin

1. Në funksion të ushtrimit të mbikëqyrjes Autoriteti mund t'i kërkojë Byrosë çdo informacion dhe dokument që ka lidhje me veprimtarinë e saj.
2. Byroja është e detyruar t'i vërë në dispozicion Autoritetit çdo dokument të kërkuar, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 6

Përmbajtja e raportimit

Byroja është e detyruar të raportojë dhe depozitojë në Autoritet:

- a. Financimin, investimin dhe administrimin e vlerës minimale të Fondit të Kompensimit me qëllim pagesën e dëmeve sipas nenit 41 të Ligjit nr. 32/2021;
- b. Financimin, investimin dhe administrimin e fondit të garancisë së Kartonit Jeshil dhe fondit të pagesës së dëmeve të Kartonit Jeshil;
- c. Statutin e Byrosë apo ndryshimet e tij, të propozuara nga asambleja e përgjithshme e anëtarëve;
- d. Dokumentacionin për miratimin e organeve drejtuese sipas kërkesave ligjore dhe nënligjore të kualifikimit, përvojës dhe përshtatshmërisë të përcaktuara në ligjin për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit;

- e. Buxhetin vjetor të Byrosë dhe pjesën e financuar nga anëtarët e Byrosë si dhe çdo burim tjetër financimi;
- f. Dokumentacionin për miratimin nga Autoriteti të shoqërisë audituese që do të auditojë pasqyrat financiare vjetore të Byrosë;
- g. Njoftimin për pajisjen e anëtarëve të Byrosë me certifikata ndërkombëtare të sigurimit (Karton Jeshil);
- h. Specimenet e policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit;
- i. Pasqyrat financiare së bashku me raportin e shoqërisë audituese të pasqyrave financiare;
- j. Të dhëna statistikore mujore dhe progresive në lidhje me pagesat dhe detyrimet e dëmeve objekt Fond Kompensimi sipas nenit 41 dhe 43 të Ligjit nr. 32/2021, Karton Jeshil dhe MoU;
- k. Kontributin e shoqërive të sigurimit anëtare të Byrosë, për pagesën e dëmeve Fond Kompensimi sipas nenit 41 të Ligjit nr. 32/2021 dhe dëmeve Karton Jeshil;
- l. Thirrjet e garancive të Kartoneve Jeshil;
- m. Raportin dhe opinionin e aktuarit në lidhje me provigjonet e dëmeve sipas nenit 41 dhe 43 të Ligjit 32/2021.

Neni 7

Miratimi i financimit të Fondit të Kompensimit

1. Brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, Byroja i propozon për miratim Autoritetit:
 - a. Shumën e kontributeve të çdo shoqërie sigurimi për financimin e Fondit të Kompensimit të vitit pasardhës e përlllogaritur sipas metodologjisë përkatëse;
 - b. Çdo burim tjetër të financimit të Fondit të Kompensimit.
2. Llogaritja e kontributeve të Fondit të Kompensimit, bëhet mbi bazën e primeve bruto të shkruara të sigurimit të detyrueshëm motorik të vitit, përjashtuar Karton Jeshil, të marrë zyrtarisht nga Autoriteti.
3. Autoriteti vendos çdo vit brenda muajit janar shumën e kontributeve të Fondit të Kompensimit.
4. Kur Fondi i Kompensimit rezulton i pamjaftueshëm për të kryer pagesat e dëmeve, Autoriteti kërkon nga Byroja propozim për shtesë në Fondin e Kompensimit.
5. Byroja brenda 30 ditëve nga kërkesa e Autoritetit, depoziton për miratim në Autoritet shtesën e Fondit të Kompensimit.
6. Byroja njofton shoqëritë e sigurimit për vlerën respektive të kontributit të Fondit të Kompensimit ose fondit shtesë, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e miratimit nga Autoriteti.

7. Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të paguajnë kontributet për financimin e fondit/fondit shtesë, brenda 15 ditëve kalendarike pas marrjes së njoftimit nga Byroja.
8. Byroja, është e detyruar të njoftojë brenda 5 ditëve Autoritetin, nëse një shoqëri sigurimi vepron në kundërshtim me detyrimet e parashikuar në pikën 7 të këtij neni.

Neni 8

Raportimi mbi administrimin dhe investimin e Fondit të Kompensimit

Byroja raporton në Autoritet brenda datës 10 të muajit pasardhës:

- a. Financimin, administrimin dhe gjendjen në fund të muajit të Fondit të Kompensimit;
- b. Listën analitike të dëmeve të paguara nga Fondi i Kompensimit si dhe pasqyrën përmbledhëse të dëmeve të raportuara, të paguara dhe pezull, në numër dhe në vlerë të ndara në dëme ndaj pronës dhe ndaj personit;
- c. Arkëtimet e realizuara nga paditë e kthimit (regresit);
- d. Pasqyrën e lëvizjes së llogarisë qëllimore që titullohet “Fondi i Kompensimit” të Byrosë që i korrespondojnë këtij fondi.

Neni 9

Raportimi mbi administrimin e vlerës minimale të Fondit të Kompensimit

1. Byroja mban në një llogari bankare qëllimore në njërin nga bankat e nivelit të dytë dhe/ose degët e bankave të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë fond garancie në vlerën 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë, me qëllim pagesën e dëmeve objekt Fond Kompensimi.
2. Byroja raporton në Autoritet brenda datës 31 janar të vitit ushtrimor ose sipas kërkesës së Autoritetit, gjendjen e llogarisë bankare, pasqyrën e lëvizjes të saj si dhe gjendjen e aktiveve në mbulim të vlerës minimale të Fondit të Kompensimit.

Neni 10

Raportimi mbi administrimin dhe afatet e rivendosjes së garancisë të fondit të Kartonit Jeshil

1. Çdo anëtar i Byrosë është i detyruar të depozitojë një garanci bankare pranë një banke të nivelit të dytë në Shqipëri, në shumën që përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, por jo më të vogël se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) euro, në favor të Byrosë.

2. Për qëllime të kësaj rregulloreje, garanci bankare do të konsiderohet një llogari/depozitë bankare qëllimore në njëren nga bankat e nivelit të dytë dhe/ose degët e bankave të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, e bllokuar në favor të Byrosë dhe që preket vetëm me miratimin e saj.
3. Ky fond administrohet nga Byroja dhe ka për qëllim garantimin e detyrimeve financiare, që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil.
4. Byroja raporton në Autoritet brenda:
 - a. Datës 31 janar të vitit ushtrimor, gjendjen e llogarisë bankare, pasqyrën e lëvizjes të saj si dhe gjendjen e aktiveve në mbulim të garancisë së Fondit të Kartonit Jeshil në favor të Byrosë, nga çdo anëtar;
 - b. 7 ditëve kalendarike të gjitha thirrjet e garancive të ardhura në adresë të saj nga Byrotë homologe.
5. Byroja raporton në Autoritet brenda 3 ditëve kalendarike, rastet dhe arsyet e prekjes së garancisë së Kartonit Jeshil.
6. Byroja njofton shoqërinë e sigurimit për rivendosjen e vlerës së garancisë, brenda 45 ditëve kalendarike.
7. Byroja, është e detyruar të njoftojë brenda 5 ditëve Autoritetin, nëse një shoqëri sigurimi vepron në kundërshtim me detyrimet e parashikuara në këtë nen.

Neni 11

Raportimi i fondit të pagesës së dëmeve të Kartonit Jeshil të ndodhura brenda territorit të Shqipërisë

1. Shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë në sigurimin e detyrueshëm motorik të Kartonit Jeshil janë të detyruara të kontribuojnë financiarisht në fondin e Kartonit Jeshil, në përpjesëtim të drejtë me primet e shkruara bruto në sigurimin e detyrueshëm motorik të Kartonit Jeshil, në vitin e fundit paraardhës.
2. Fondi për pagesën e dëmit të Kartoni Jeshil mbahet nga Byroja në llogari qëllimore të veçanta brenda territorit të Shqipërisë dhe Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve përcakton çdo vit shumën e këtij fondi.
3. Byroja raporton në Autoritet brenda datës:
 - a. 31 dhjetor të vitit ushtrimor, shumën e fondit të miratuar me qëllim pagesën e dëmeve të Kartonit Jeshil;
 - b. 10 të muajit pasardhës, listën analitike të dëmeve të paguara nga fondi i Kartonit Jeshil si dhe pasqyrën e dëmeve të papaguara, në numër dhe në vlerë;

- c. 10 të muajit pasardhës, arkëtimet e realizuara nga rimbursimet e dëmeve Karton Jeshil nga Byrotë homologe.
4. Byroja është e detyruar të njoftojë menjëherë Autoritetin, nëse një shoqëri sigurimi anëtare e Byrosë do të veprojë në kundërshtim me detyrimet e parashikuara në këtë nen.

Neni 12

Raporti dhe opinionin e aktuarit për provigjonet e dëmeve të Fondit të Kompensimit

1. Byroja siguron bazën e të dhënave sipas regjistrimit elektronik të dëmeve Fond Kompensimi për përlllogaritjen e provigjoneve nga aktuari i autorizuar sipas nenit 41, të Ligjit nr. 32/2021.
2. Byroja depoziton në Autoritet deri në ditën e fundit të muajit pasardhës të çdo tre mujori, për periudhat e ndërmjetme dhe të fundvitit financiar raportin dhe opinionin e aktuarit të autorizuar lidhur me përlllogaritjen e provigjoneve sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe njofton shoqëritë e sigurimit brenda këtij afati për vlerën respektive të provigjonit që do të mbajë dhe krijojë shoqëria e sigurimit.
3. Shoqëritë e sigurimit depozitojnë në Byro deri në ditën e fundit të muajit pasardhës të çdo tre mujori, për periudhat e ndërmjetme dhe të fundvitit financiar raportin dhe opinionin e aktuarit të autorizuar lidhur me përlllogaritjen e provigjoneve sipas nenit 43, të Ligjit nr. 32/2021.
4. Byroja depoziton në Autoritet raportet dhe opinionet sipas pikës 3 të këtij neni brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të tyre nga shoqëritë e sigurimi.

Neni 13

Raportimi i pasqyrave financiare

1. Byroja përgatit pasqyrat financiare për çdo vit kalendarik dhe i paraqet ato në Autoritet, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.
2. Byroja depoziton në Autoritet raportin e auditimit dhe letrën për drejtimin, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së tyre, por jo më vonë se data 30 prill e vitit pasardhës.

Neni 14

Përzgjedhja e shoqërisë audituese

1. Byroja emëron dhe miraton shoqërinë audituese, e cila është person juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari audituese në Republikën e Shqipërisë.
2. Kërkesa dhe dokumentacioni i plotë për miratimin e shoqërisë audituese, depozitohet në Autoritet jo më vonë se data 31 korrik e çdo viti kalendarik.
3. Autoriteti nëse e gjykon të nevojshme, i kërkon Byrosë plotësim dokumentacioni dhe informacion shtesë brenda një afati të caktuar prej tij.
4. Kriteret dhe dokumentacioni për përzgjedhjen e shoqërisë audituese të Byrosë janë të njëjta me ato të përcaktuara në rregulloren e Autoritetit “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”.
5. Shoqëria audituese e propozuar nga Byroja miratohet ose refuzohet nga Autoriteti, brenda 2 muajve nga data e paraqitjes së plotë të kërkesës.

Neni 15

Raportimi i buxhetit

1. Byroja, i propozon për miratim Autoritetit, projekt buxhetin për vitin pasardhës, brenda datës 30 nëntor të çdo viti.
2. Financimi i buxhetit bëhet nga shoqëritë e sigurimit brenda 30 ditëve kalendarike nga miratimi i tij nga Autoriteti.
3. Çdo tepricë e të ardhurave mbi shpenzimet, të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave të Byrosë, do të transferohet në vitin e ardhshëm dhe do të merret parasysh gjatë përcaktimit të shumës së nevojshme për financimin e buxhetit të Byrosë për vitin.
4. Në rast se buxheti i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer veprimtarinë e Byrosë, shoqëritë e sigurimit financojnë shtesë të buxhetit.
5. Byroja raporton në Autoritet financimin e buxhetit shtesë, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e derdhjes së tij në llogarinë përkatëse.

Neni 16

Miratimi i specimenit të policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit

1. Byroja depoziton në Autoritet për miratim, specimenin e policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

2. Autoriteti, miraton specimenin e depozituar, brenda 30 ditëve pune nga data e depozitimit.
3. Byroja, fillon procedurën për emetimin dhe prodhimin e policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, pas miratimit nga Autoriteti.

Neni 17

Raportime të tjera në Autoritet

Byroja depoziton në Autoritet brenda:

- a. 5 ditëve kalendarike nga data e miratimit të saj nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, statutin si dhe çdo ndryshim apo përmirësim të tij. Autoriteti mund të kërkojë ndryshimin e statudit nëse bie në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe ia kthen për rishikim atë Byrosë;
- b. 5 ditë kalendarike përpara datës së zhvillimit të mbledhjes, njoftimin për datën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes së bordit të drejtorëve;
- c. 5 ditëve kalendarike, një kopje të vendimeve të marra në mbledhjen e asamblesë së anëtarëve të byrosë, të të gjitha rregulloreve me objekt veprimtarinë e Byrosë dhe vendimeve sipas parashikimeve të akteve ligjore në fuqi;
- d. Datës 10 të muajit pasardhës, raportimin periodik sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe formularëve të standardizuar bashkëngjitur.

Neni 18

Miratimi i emërimit/ riemërimit të anëtarit të bordit të drejtorëve dhe drejtorit ekzekutiv

1. Byroja depoziton në Autoritet vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve për miratimin e emërimit/riemërimit të anëtarëve të bordit të drejtorëve si dhe të drejtorit ekzekutiv.
2. Anëtarët e bordit të drejtorëve apo familjarët e tyre nuk mund të jenë palë të lidhura me shoqëritë e sigurimit anëtare të Byrosë apo shoqëritë që auditojnë pasqyrat financiare të Byrosë.
3. Anëtarët e bordit të drejtorëve dhe drejtori ekzekutiv, duhet të plotësojë të gjithë kërkesat ligjore dhe nënligjore të kualifikimit, përvojës dhe përshtatshmërisë së anëtarit të drejtorisë së një shoqërie sigurimi, sipas përcaktimeve të ligjit “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe rregullores “Për procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/ mbikëqyrës, administratorit/ anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”.

4. Autoriteti, pas shqyrtimi të të gjithë dokumentacionit të kërkuar, miraton apo refuzon anëtarët e bordit të drejtorëve dhe drejtorin ekzekutiv, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të vendimit të asamblesë së përgjithshme të anëtarëve.

Neni 19

Procedura e pajisjes së anëtarëve me Karton Jeshil

1. Byroja, depoziton në Autoritet kërkesën për pajisjen me Karton Jeshil të anëtarit të saj, së bashku me programin e risigurimit.
2. Autoriteti shqyrton përputhshmërinë e programit të risigurimit sipas akteve ligjore në fuqi dhe njofton Byronë dhe shoqërinë e sigurimit për përshtatshmërinë ose jo të programit të risigurimit.
3. Byroja pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti sipas pikës 2 të këtij neni, vijon me dhënien e autorizimit anëtarit për të lëshuar Karton Jeshil.
4. Byroja njofton Autoritetin brenda 3 ditëve kalendarike nga data e dhënies së autorizimit, sipas pikës 3 të këtij neni.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 1 korrik 2021.

Aneks 1-Formular 1

Tabela 1- Dëmet e paguara Fond Kompensimi sipas nenit 41 të ligjit 32/2021 (muajore)

Nr	Datë aksidenti	Nr. referencës së praktikës	Shoqëria e sigurimit	Përfituesi	Shkaktari	Vlera e paguar	Data e pagesës
Total							

Tabela 2 -Dëmet e paguara Fond Kompensimi sipas rregullores "Për mënyrën e administrimit dhe pagesave të dëmeve fond kompensimi me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 32/2021" (muajore)

Nr	Datë aksidenti	Nr. referencës së praktikës	Shoqëria e sigurimit	Përfituesi	Shkaktari	Vlera e paguar	Data e pagesës
Total							

Tabela 3- Dëmet e paguara Fond Kompensimi sipas nenit 43 të ligjit 32/2021 (muajore)

Nr	Datë aksidenti	Nr. referencës së praktikës	Shoqëria e sigurimit	Përfituesi	Shkaktari	Vlera e paguar	Data e pagesës
Totali							

Të dhënat e Tabelave 1 dhe 2 janë aneks plotësues i Formularit nr. 1

Formular 2

Dëme të Papaguara Fond Kompensimi

Gjendja deri më datë ----/----/-----

Nr	Shoqëria e sigurimit	Dëme FK në trajtim		Dëme FK të miratuar		Dëme FK sipas Vendimeve Gjyqësore		Dëme FK në Zyrat Përmbarimore		Totali Dëmeve FK të papaguara	
		Nr. prak	Vlerë dëmi	Nr. prak	Vlerë dëmi	Nr. prak	Vlerë dëmi	Nr. prak	Vlerë dëmi	Nr. prak	Vlerë dëmi
		a		b		c		d		e=a+b+c+d	
Totali											

Në zbatim të Rregullores "Për standartet e raportimit dhe mbikëqyrjes së BSHS-së" të dhënat e raportuara sipas formularit 2 për dëmet pezull fond kompensimi janë të regjistruara në Regjistrin Elektronik të Administrimit të dëmeve Fond Kompensimi.

Aneks 1 -Formular 2

Tabela 1- Dëme papaguar Fond Kompensimi-Proces Gjyqësor Shkallë e Parë dhe Apel

Nr	Shoqëria e sigurimit	Proces gjyqësor Shkalla e parë						Proces gjyqësor Apel				Totali	
		Nr. prak	Vlera pretenduar	Nr. prak	Vlera e vendimit	Nr. prak	Vlera e Ekzekutueshme	Nr. prak	Vlera e vendimi	Nr. prak	Vlera e Ekzekutueshme	Nr. prak	Vlera
		a		b		c		d		e		f=a+b+c+d+e	
Totali													

Tabela 2-Dëme papaguar Fond Kompensimi- Proces Gjyqësor Shkallë e Lartë

Nr	Shoqëria e sigurimit	Gjykatë e Lartë			
		Nr. prak	Vlera pretenduar	Nr. prak	Vlera vendimi
		a		b	
Totali					

Të dhënat e tabelave 1 dhe 2 janë aneks plotësues i Formularit nr. 2

Aneks 1-Formular 6

Tabela 1 -Arkëtime të Padive të Regresit për periudhën (mujore)

Nr	Shoqëria e sigurimit	Nr	Dëme të paguara deri në datën	Nr	Dëme të regresuara deri në datën	Nr	Dëme të arkëtuara deri në datën

Tabela 2- Arkëtime të Padive të Regresit (progresive)

Nr	Shoqëria e sigurimit	Nr	Dëme të paguara deri në datën	Nr	Dëme të regresuara deri në datën	Nr	Dëme të arkëtuara deri në datën

